



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në bazë të nenit 17 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe ansferte, nr. 01/111-400 të datës 28 maj 2012 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, si dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2020, nr. 01-400/-03-0075925/19, datë 23.09.2019, bën:

FTESË PUBLIKE

Për aplikim në projektin:

“MOTOKULTIVATOR ME PAJISJE PËRCJELLËSE PËR PERIMKULTURË DHE PEMISHTE”

(Projekti do të realizohet në bashkëpunim me përfituesit)

Subvencionimi në projektin e cekur realizohet përmes formës së participimit financiar nga ana e fermerëve përfitues.

Fermerët përfitues do të marrin pjesë me **30%** të vlerës së projektit.

Komuna në cilësinë e subvencionuesit do të marrë pjesë me **70%** të vlerës së projektit.

Fermerët përfitues para lidhjes së kontratës do të paguajnë **30%** të vlerës së kontratës në llogarinë bankare të Komunës.

KUSHTET PËR APLIKIM

- Të jetë banor i Komunës së Podujevës (kopja e letërnjoftimit)
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme
- Në mungesë të certifikatës mbi pronësinë, kontrata mbi marrjen me qira të tokës në kohëzgjatje së paku 15 vite
- Vërtetimi i tatimit në pronë
- Dëshmia e sipërfaqes së mbjellur me perimkulturë ose pemishte mbi 50 ari;
- Certifikata e bashkësisë familjare;

- Afati i aplikimit: nga data **18.08.2020** deri më **31.08.2020**

- Aplikacionet dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhësë.

Nr. 12-320/01-0047502/20
Podujevë, 18 gusht 2020



Drejtori
Vezir Januzi